

RELACION

RAPORT MONITORIMI 4 MUJORI DYTE VITI 2018

Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me Ligjin Nr. 109 datë 30.11.2017 i është miratuar buxheti fillestar për vitin 2018 prej 47.542.630.000 lekë, për 11 programe buxhetore.

Me Aktin Normativ nr.1, datë 26.07.2018, “Për disa ndryshime në ligjin nr.109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, buxheti është rritur me 780.000 lekë për shpenzime korrente dhe janë pakësuar shpenzimet kapitale me financim të brendshëm me 202.592 lekë dhe shpenzimet kapitale me financim të huaj me 160.000 lekë duke arritur buxhetin në total në vlerën 47.960.038.000 lekë.

Monitorimi i shpenzimeve sipas programeve

1. PLANIFIKIM MENAXHIM ADMINISTRIMI

Qëllimi dhe objektivat e politikës së programit janë të lidhura me funksionimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative të Aparatit të Ministrisë së Infrastruktës dhe Energjisë, rritjen e standardeve dhe performancës së punës.

Në këtë program janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Aparatit të ministrisë, shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqerore) plani vjetor 2018 prej 362,7 milion lekë paraqitet me realizim faktik në vlerën 205.6 milion lekë ose rreth 57%.

Shpenzimet operative, plani vjetor 2018 është në shumën 399.6 milion lekë ndersa realizimi faktik është në vlerën 278,6 milion lekë ose 70%. Në këtë kategori shpenzimesh përfshihen edhe shpenzimet për familje të subvencionuara për transportin e trupave të sjellë në Shqipëri si dhe shpenzime për pagesa të anëtarësimeve në organizatat ndërkombëtare.

Investimet me financim të brendshëm, në këtë program, janë në shumën 51,287 mijë lekë dhe realizimi financiar për periudhën e 4-mujorit të dytë të vitit 2018, është në shumën 219 mijë lekë, kjo për shkak se projektet e investimeve të planifikuara për periudhën 8 mujore janë në proces prokurimi, lidhjes së kontratave ose kryerjes së punimeve të cilat priten të likujdohen me përfundimin e punimeve.

2. TRANSPORTI RRUGOR

Buxheti i shpenzimeve kapitale (me financim të brendshëm) është 16,305,041 lekë, ose e shprehur në përqindje 41 % e planit të buxhetit të vitit 2018.

Me Aktin Normativ nr.1, datë 26.07.2018, u pakësuan fondet për shpenzimet korrente në shumën prej 3,5 milion lekë, investimet me financim të brendshëm u shtuan me 250 milion lekë dhe investimet me financim të huaj u pakësuan me 750 milion lekë.

Realizimi i detajuar për çdo objekt rrugor, jepet në informacionin përkatës “Mbi realizimin e Investimeve Rrugore” (bashkëlidhur), Tabela nr.10 “Projektet me financim të brendshëm” (Aneksat e Monitorimit).

Nga të dhënat “Raporti i realizimit të produkteve dhe i shpenzimeve faktike të programit sipas produkteve” rezulton se:

Grupi i produktit “*Ndërtim Rruge*” i shprehur në sasi (km) për 8 mujorin e vitit 2018 është realizuar ndaj planit vjetor përkatësisht 38.1 % (ose 6.77 km) dhe i shpenzimeve faktike për këtë produkt 33.8 % ose 3,210,334,000 lekë.

Produktet e shprehur në terma sasiore (km) sipas tipeve të ndërtimit të rrugëve (tip A2 me katër korsi, A2’ 2x2 me trotuare dhe ndriçim, B1’ me dy korsi, C2 dhe me dy korsi), janë planifikuar për 8 mujorin e vitit 2018 konkretisht:

PLANIFIKUAR	FINANCUAR
A2- 0.52 km	0.28 km ose 53.8%
A- 0.44 km	0.0 km ose 0% me standardin e ri
A2’- 3.56 km	2.69 km ose 75.6%
B1’- 10.34 km	2.56 km ose 24.8%
C2- 2.29 km	1.24 km ose 54.1%
C2’- 0.64km	0.00 km ose 0%

Për zërin “*Ndërtim rruge*” është akorduar fond për kontratat në vazhdim dhe për kontrata e reja që janë çelur me buxhetin e vitit 2018.

Grupi i produktit “*Rikonstruksion Rruge*” i shprehur në sasi (km) për 8 mujorin e vitit 2018 është realizuar rreth 90.4 % ndaj planit vjetor të vitit 2018 (ose 18.57 km), dhe i shpenzimeve faktike për këtë produkt 70.2 % ose 1,364,025,000 lekë.

Shpenzimet e këtij grupi janë planifikuar për financimin e rrugëve Tip C2 me dy korsi.

Produktet e shprehur në terma sasiore (km) sipas tipeve për rikonstruksionin e rrugëve (tip C2 & B’ me dy korsi dhe A2’ 2x2 me trotuare dhe ndriçim), janë planifikuar për 8 mujorin e vitit 2018 konkretisht:

PLANIFIKUAR	FINANCUAR
C2- 20.54 km	18.57 km ose 90.4%

Edhe për zërin “*Rikonstruksion rruge*” është akorduar fond për kontratat në vazhdim.

Ndërtim rruge tip A2 me katër korsi (2x2):

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 1,031,890,000 lekë (10.9 % ndaj planit total vjetor (Grupi i produktit “*Ndërtim Rruge*”) dhe në sasi 0.52 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit janë në vlerën 443,777,000 leke (4.7 % ndaj planit vjetor “Grupi i produktit “*Ndërtim Rruge*”) ose (43 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi 0.28 km ose 53.8 % të planit për këtë tip rruge. Përfshihen në këtë grup rrugë me katër korsi dhe gjerësi 20-25 m, me disa objekte të rëndësishëm si:

- Ndërtim By pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë “ nga Loti 8 deri në Lotin 11,
- Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti2 (dy viadukte) dublimi
- Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti1, (V.Arta të mëdha) dublimi”.
- Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti2 (dy viadukte) dublimi (shtese punimesh)
- Plotesim, rakordim, masa mbrojtëse dhe siguri rrugore ne viaduktet e aksit Kukës-Morinë.
- Vendosja e mbikalimeve ne aksin rrugor Thumane - Milot dhe Kukës – Morinë.

Ndërtim rruge tip A me katër korsi (2x2) sipas Standarteve të Reja:

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 1,222,600,000 lekë (12.9 % ndaj planit total vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) dhe në sasi 0.44 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit janë në vlerën 0 leke (0 % ndaj planit vjetor “Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”). Përfshihen në këtë grup rruge:

-Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rreth rrotullimi Shqiponja Loti 1, Loti 2, Loti 3.

Ndërtim rruge tip A2’ 2x2 me trotuare dhe ndriçim:

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 3,769,575,000 lekë (40 % ndaj planit të përgjithshëm vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) dhe në sasi 3.56 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 2,168,762,000 lekë (22.8% ndaj planit vjetor Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) ose 57.5 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 2.69 km ose 75.6 % të planit për këtë tip rruge.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me katër korsi dhe gjërësi që varion nga 24-25 m, me disa objekte të rëndësishëm që janë në proces si:

- Ndërtim Unaza e Re e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës.
- Ndërtim rruga Unaza e re Tiranës (segmenti Komuna e Parisit - rruga e re Tiranë - Elbasan).
- Rikonstruksion segmenti rrugor Kodër-Kamëz Tapizë+ shtesë punimesh
- Ndërtim Unaza e Re e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit - Shk Teknologjike pjesa e mbetur km 0.00-0.640.
- Plotësimi dhe përfundimi i objektit - Ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës , Komuna e Parisit - Shkolla Teknologjike,pjesa e mbetur km 0.00-km0.640+ shtesë punimesh.
- Ndërtim nyja lidhëse e rrugës Milot-Lezhë, Rrëshen, Thumanë.
- Ndërtim i unazës së Jashtme Tiranë pjesa verilindore (seg Kth Saukut-Bregu i lumit) Loti 1+ shesë punimesh, Loti 2, Loti 3+ shtesë punimesh.
- Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1 + shtesë punimesh, Loti 2.

Ndërtim rruge tip B1’ me dy korsi:

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 1,929,050,000 lekë (20.3 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) dhe në sasi 10.34 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 120,544,000 lekë (6.3 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) ose (1.3 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 2.56 km ose 24.8 % të planit të këtij tipi rruge.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 10-17 m, duke përmendur disa objekte të rëndësishme në të cilat punohet me ritme të parashikuara :

- Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 1, Loti 2, Loti 3,
- Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 4, Loti 5, Loti 6,
- Ndërtim rruga Milot - F. Krujë (dublimi i superstradës) Loti3,
- Ndertim Unaza Kavaje (Vazhdimi)

Ndërtim rruge tip C2 dhe C2’ me dy korsi:

Për **tipin e rrugës C2** janë planifikuar fonde në vlerën 1,539,819,000 lekë ose 16 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) dhe në sasi 2.29 km.

Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C2 është 477,251,000 lekë (5 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) ose (31 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi jane realizuar 1.24 km ose 54.1 % të planit të këtij tipi rruge.

Janë përfshirë kryesisht tip rruge C2 me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 7.5-10 m.

Po punohet normalisht në objektet që janë në proces:

- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore -vazhdimi Loti 1,
- Rikonstruksioni aksit rrugor ura e Gajdarit hyrja Sarandë.
- Ndërtim i aksit Skrapar-Përmet Loti 1+ shtesë punimesh.
- Ndërtim mbrojtja nga lumi km 9+500 rruga e re Milot-Skuraj.
- Përmirësim i sigurisë rrugore në aksin Kashar – Rinas.

Për **tipin e rrugës C2'** janë planifikuar 9,845,000 lekë ose 0 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) dhe në sasi 0.64 km.

Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C2' është 0 lekë (0. % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) ose (0 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 0 km.

- Ndërtim i rrugëve sekondare Vidhas-Kombinati Metalurgjik (shtesë kontrate).

Rikonstruksion rruge tip C2 me dy kors:

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 1,941,917,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Rikonstruksion Rruge) dhe në sasi 20.54 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 1,364,025,000 lekë (70 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Rikonstruksion Rruge) ose (70 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 18.57 km ose 90.4 % kundrejt planit të këtij tipi rruge.

Përfshihen kryesisht (Sistemim Asfaltim) rruge me gjërësi deri 8.5 metra tip C2.

Janë në proces ndërtimi disa objekte të rëndësishme si:

- Riveshje dhe Sistemim Asfaltim Elbasan- Banjë Loti 1 (shtesë punimesh), Loti 3+ (shtesë punimesh).
- Sistemim asfaltim rruga Tri Urat-Leskovic (shtesë punimesh).
- Përmirësimi i shtresave rrugore dhe i sinjalistikës segmenti rrugor Fushë - Kruj – Thumanë (shtesë punimesh).
- -Sistemim asfaltim masa inxhinierike ne Km.21+050, në rrugën Qafë Thanë Lin-Pogradec + (shtesë punimesh.)
- Pjesa e mbetur e punimeve në segmentin Lin-Pogradec, km 4 deri 21.
- Riveshje dhe Sistemim Asfaltim rruga Përmet – Këlcyrë Loti 3+ (shtesë punimesh).
- Plotësimi i punimeve të mbetura dhe lidhja me rrugën ekzistuese të objektit Sistemim
- Asfaltim Rruge Korçë - Ersekë, Loti 1.
- Sistemim Asfaltim Rrugët lidhëse me bregdetin (Llogara-Sarandë) Loti 1+(shtesë punimesh).

Grupi i shpenzimeve *Shpronësime dhe Vendime gjyqësore, garanci objekti, leje mjedisore dhe ura, të tjera*, paraqiten si më poshtë:

PLANIFIKUAR	REALIZUAR
-Vendime gjyqësore 200,000,000 lekë	200,000,000 lekë ose 100% e planit
-Shpronësime 301,000,000 lekë	193,632,661 lekë ose 64 % e planit
-Blerje pajisje kompiuterike për ARRSH, 17,562,820 lekë	16,939,600 lekë ose 96 % e planit
-Blerje pajisjesh për akreditimin e Laboratorit të ARRSH-së. 5,535,000 lekë	5,535,000 lekë ose 100% e planit

-Fond Emergjence Total

30,000,000 lekë 0 lekë ose 0 % e planit.

-Objekte të tjera 71,000,000 lekë 0 lekë ose 0 % e planit

Shpenzimet kapitale për *TVSH dhe Kosto Lokale* së bashku janë planifikuar fonde në vlerën 2,881,645,435 lekë ose (19 % ndaj planit vjetor) dhe janë financuar për 8 mujorin e vitit 2018 si më poshtë:

-Kosto Lokale 781,155,835 lekë 389,436,385 lekë ose 50% e planit

-TVSH e T.D 2,100,489,600 lekë 1,009,641,293 lekë ose 48 % e planit

Detyrimet e krijuara rishtazi dhe të prapambetura për investimet janë 1,2 miliard lekë ndërsa për kontratat e mirëmbajtjes janë 1,1 miliard lekë.

FINANCIMI I HUAJ

Buxheti i financimit të huaj për vitin 2018 është 6,595,000 lekë , i cili në 8 mujor është financuar në vlerën 2,226,849,000 lekë ose 34 % e planit.

Në sasi në zërin ndërtim rrugësh Kategoria B, C edhe Kategori të ndryshme (Mirëmbajtja) janë planifikuar 3,042 km dhe janë realizuar 410 km.

Ndërtim Rruge Tip B

Për **tipin e rrugës B** janë planifikuar fonde në vlerën 5,501,637,000 lekë dhe në sasi 65 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës B për 8 mujorin është 1,940,114,000 lekë ose 35.3 % e planit.

Në sasi janë realizuar 22 km të këtij tipi rruge.

Ndërtim Rruge Tip C

Për **tipin e rrugës C** janë planifikuar fonde në vlerën 260,000,000 lekë dhe në sasi 40 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C është 4,322,000 lekë ose 2 % e planit.

Në sasi janë realizuar 1 km të këtij tipi rruge.

Ndërtim Rruge Tip Kategori të Ndryshme

Për **tipin e rrugës Kategori të Ndryshme** janë planifikuar fonde në vlerën 1,583,363,000 lekë dhe në sasi 2937 km. Realizimi i shpenzimeve është 282,413,000 lekë ose 18 % e planit.

Në sasi janë realizuar 282 km të këtyre kontratave.

3. TRANSPORTI DETAR

Në programin buxhetor "Transporti detar" për katërmujorin e dytë të vitit 2018, buxheti i planifikuar është 169,4 milion lekë dhe katër mujorin e dytë është realizuar në shumën 68,9 milion lekë, ose 40,6 % kundrejt planit.

Per periudhen e kater mujorit te dyte jane realizuar produktet :

Produkti A. Administrata e Drejtorisë së Përgjithshme Detare, funksionale, planifikimi i fondeve buxhetore për shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative, është në vlerën 108,2 milion lekë dhe realizimi financiar është 55,5 milion lekë ose 51,2 % kundrejt planit.

Produkti B. Konservimi i Ndërmarrjes së Kontroll Shfrytëzimit të Mjeteve Ujore për vitin 2018, është planifikuar fondi 3 milion lekë dhe realizimi financiar është në vlerën 2,4 milion lekë, ose 80 % ndaj planit, me të cilën janë paguar pagat e punonjësve për ndërmarrjen.

Produkti C. Projekti "Ndërtim i sistemit të LRIT", me buxhet në shumën prej 28 milion lekë, nuk ka realizim financiar. Agjencia Kombëtare e Shërbimit Informatik është shprehur se kjo procedurë prokurimi është jashtë kompetencave të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, pasi është projekt TIK në fushën e përgjegjësisë së AKSHI. Proçedura e prokurimit do të zhvillohet nga AKSHI.

Produkti D. Projekti "Ndërtim i godinës së Kapitenerisë Shengjin", me buxhet prej 11 milion lekë, realizim financiar në shumën 10,9 milion lekë, ose 99 % e realizuar. Investimi ka filluar në vitin 2017 dhe me buxhetin e realizuar të vitit 2018, ky investim u realizua plotësisht.

Me Aktin Normativ nr. 1, datë 26.07.2018, është miratuar buxhet shtesë në vlerën 20,8 milion lekë, për detyrimet e prapambetura me fatura të prera për TVSH-në, për projektet:

"TVSh dhe taksë doganore për projektin e kalatës së në Portin e Shëngjinit" në vlerën 1,6 milionë lekë;

"TVSh dhe taksë doganore për projektin e rehabilitimit të kalatës Portit Vlorë", në vlerën 19,2 milion lekë;

4. TRANSPORTI HEKURUDHOR

Programi ka për qëllim Integrimin e Sistemit Hekurudhor Shqiptar me atë Rajonal dhe Evropian nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave zhvilluese në fushën e infrastrukturës dhe mjeteve të transportit hekurudhor .

Plani i buxhetit për vitin 2018, i ndryshuar me AN , në këtë program është 608.680 mijë lekë:

Shpenzime korrente	423,680,000
Shpenzime kapitale	185,000,000
- <i>financim i brendshëm</i>	65,000,000
- <i>financim i huaj (grand/kredi)</i>	120,000,000

Reformimi i Sistemit Hekurudhor Shqiptar nëpërmjet hartimit të 6 akteve nënligjore dhe fillimit të procesit të ndarjes administrative të sistemit hekurudhor.

Për këtë akordohen subvencion (art 603) 400 000 milion lekë

Drejtimet e ku janë fokusuar politikat zbatuese me mbështetje buxhetore apo të financimit të huaj janë si më poshtë:

Transformimi i Infrastruktures Hekurudhore dhe i mjeteve levizese në sistemin hekurudhor nëpërmjet studimeve dhe projektve për rikostruksion të linjave të vjetra dhe ndërtimin e linjave të reja.

Ruajtja e statusquo se sistemit hekurudhor nëpërmjet mirmbajtjes së infrastruktures dhe mjeteve hekurudhore si dhe kontrollit të sigurisë në levizje.

5. TRANSPORTI AJROR

Në këtë program janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Organit Kombëtar të Incidenteve/Aksidenteve Ajrore, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për mbarëvajtjen e funksionimit të kësaj strukture si dhe investime të nevojshme për këto institucion.

Në këtë program buxhetor është përfshirë Shërbim Konsulence për asistencën e Komisionit të Negocimit midis Shtetit Shqiptar dhe Kompanisë CENGIZ construction & Kalyon & Kolin për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës.

Objektivat dhe produktet të cilat synohen të arrihen gjatë kësaj periudhe, përgjithësisht janë të lidhur me:

- zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturave të reja aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuar
- rritjen e standarteve dhe performancës së Organit Kombëtar të incidenteve/Aksidenteve ajrore nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve,

Për vitin 2018 janë planifikuar investime për administratën e OKIIA-s, në vlerën 5 milion lekë, që lidhen me pajisje për inspektorët e investigimeve ajrore si dhe të ambienteve të stafit, realizimi i të cilave për periudhën 8 mujore është në masën 18.48 %, për shkak të mos kryerjes së procedurave të prokurimit nga ana e OKIIA-s.

Për vitin 2018 gjithashtu është planifikuar shërbim Konsulence për asistencën e Komisionit të Negocimit për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës, në vlerën **24 milion lekë**.

6. FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME

Investimet buxhetore për rezultatin për rezultatin A/II: Linjë e re ujësjellësi për furnizimin me ujë, të përfshira në planin e vitit 2018, janë planifikuar në vlerën 1,630,423 mijë lekë dhe në përfundim të periudhës raportuese është realizuar financimi në vlerën 716,418 mijë lekë ose rreth 44% e planit të akorduar. .

Investimet buxhetore për rezultatin A/III: Rrjet kanalizimesh të ujrave të zeza i shtruar, të përfshira në planin e vitit 2018, janë planifikuar në vlerën 328,893 mijë lekë dhe realizimi i financimit është 186,171 mijë lekë, ose 57 % e planit të akorduar.

Investimet buxhetore për rezultatin A/IV: Impiant i trajtimit të ujrave të zeza, të përfshira në planin e vitit 2018, janë planifikuar në vlerën 724,978 mijë lekë dhe realizimi i financimit është 215,632 mijë lekë, ose 30% e planit të akorduar.

Investimet buxhetore për rezultatin A/V: Diga e HEC Banjës i trajtuar, të përfshira në planin e vitit 2018, janë planifikuar në vlerën 3,000 mijë lekë dhe realizimi i financimit është 2,714 mijë lekë ose 90% e planit të akorduar.

Investimet buxhetore për rezultatin A/V: Leje infrastrukturore, të përfshira në planin e vitit 2018, janë planifikuar në vlerën 3,000 mijë lekë dhe realizimi i financimit është 2 mijë lekë.

Investimet buxhetore për rezultatin A/VII: Shpronësime, të përfshira në planin e vitit 2018, janë planifikuar në vlerën 10,000 mijë lekë dhe nuk ka realizimi të këtyre fondeve për periudhën raportuese.

Investimet buxhetore për rezultatin A/V: Supervizion punimesh, të përfshira në planin e vitit 2018, janë planifikuar në vlerën 28,754 mijë lekë dhe realizimi i këtyre fondeve për periudhën raportuese është në vlerën 6,227 mijë lekë ose 22% e planit të akorduar.

Investimet buxhetore për rezultatin A/VIII: Studim dhe Oponence, të përfshira në planin e vitit 2018, janë planifikuar në vlerën 53,163 mijë lekë dhe realizimi i këtyre fondeve për periudhën raportuese është në vlerën 12,881 mijë lekë ose 24% e planit të akorduar.

Realizimi sipas produkteve për objektet me Financim të Huaj:

Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/I: Linjë e re ujësjellësi për furnizimin me ujë: Për vitin 2018 janë planifikuar 2,130,107 mijë lekë, nga të cilat për këtë periudhë raportimi janë realizuar 1,565,807 mijë lekë ose 74 % e fondeve të akorduara.

Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/III: Rrjet kanalizimesh të ujrave të zeza i shtruar janë planifikuar 166,716 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 5,963 mijë lekë ose 4% e fondeve të akorduara.

Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/IV: Ndërtim Impianti i Trajtimit të Ujrave të Zeza janë planifikuar 2,191,765 mijë lekë nga të cilat për periudhën raportuese janë realizuar 866,774 mijë lekë ose 40 % e fondeve të akorduara.

Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/VII: Konsulencë, janë planifikuar 2,564,000 mijë lekë, nga të cilat për periudhën raportuese janë realizuar 314,953 mijë lekë ose 12% e fondeve të akorduara.

Për studime, projektim dhe oponencë teknike për vitin 2018 janë planifikuar 53,163 mijë lekë dhe realizimi është 12,883 mijë lekë ose 24% të planit të akorduar.

Për investime me financim të brendshëm për vitin 2018 janë planifikuar 3,909,837 mijë lekë dhe u realizuan 1,368,399 mijë lekë ose 35% të planit të akorduar.

Për investime me financim të huaj për vitin 2018 janë planifikuar 5,871,800 mijë lekë dhe janë financuar 2,512,269 mijë lekë ose 43% të planit të akorduar.

Për subvencione për ndërmarrjet / sha. ujësjellës kanalizime për vitin 2018 janë planifikuar 1,000,000 mijë lekë. Shpërndarja e fondeve për subvencion për ndërmarrjet SHA UK ende nuk është kryer.

7. MBETJET URBANE

1. Për produktin “Administrimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë, Faza e dytë”, është planifikuar mbështetja buxhetore financim i huaj me vlerë 50,000,000 lekë. Për këtë produkt është planifikuar mbështetja buxhetore me TVSH 10,000,000 lekë. Nga monitorimi i produktit për 4 mujorin e II, të vitit 2018 rezulton se nga financimi i huaj disbursuar 325,550 lekë dhe nga financimi i brendshëm (tvsh) janë disbursuar 4,249,867 lekë. Problematikë gjatë zbatimit të projektit ka qenë pengesa e ndërtimit të stacionit të transferimit të mbetjeve në Pogradec nga banorët e zonës.
2. Produkti “Venddepozitimi i Bushatit i ndërtuar”(faza II), është planifikuar dhe financuar me vlerë 50,000,000 lekë.
3. Produkti “Studim dhe masa shoqëruese për sistemin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun e Beratit”, me vlerë 50.000.000 lekë nuk është realizuar për arsye të procedurave të prokurimeve dhe të nënshkrimit të kontratave.

4. Produkti “Sistemi i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Qarkun e Vlorës”, me vlerë 400.000.000 lekë nuk është realizuar akoma për arsye të procedurave të prokurimeve dhe të nënshkrimit të kontratave.
5. Produkti “Inceneratori i Fierit”, planifikuar 752.772.000 lekë janë disbursuar 501,846,816 lekë, vazhdon financimi sipas zbatimit të kontratës.
6. Produkti “Inceneratori i Elbasanit”, planifikuar 661,500,000 lekë janë disbursuar 355,721,871 lekë, vazhdon financimi sipas zbatimit të kontratës.
7. Projekti “Inceneratori i Tiranës”, ne buxhetin e vitit 2018, ishte planifikuar shuma prej 500 milion leke ne zerin investime me financim te brendshem. Me aktin Normativ nr. 1, date 26.07.2017, eshte akorduar shuma 253 milion leke, dhe per kete projekt buxheti arrin ne 753 milion leke. Gjithashtu ne zbatim te kontrates koncesionare projekti ne strukturen buxhetore eshte perfshire ne zerin shpenzime operative 602, me autoritet Bashkine Tirane. Per periudhen 8 mujore, eshte financuar e gjithe shuma, e planifikuar.

8. MBESHETJE PER BURIMET NATYRORE

Fondet buxhetore në kete program, përgjithësisht janë fonde të nevojshme në mbështetje të politikave lidhur me fushën e menaxhimit të burimeve natyrore që synojnë jo vetëm zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar por dhe në rritjen e transparencës në shfrytëzimin racional të burimeve natyrore.

Buxheti i vitit 2018, për investimet me financim të brendshëm, ishte parashikuar në shumën prej 393,7 milion lekë. Me Aktin normativ nr. 1, datë 26.07.2018 buxheti i këtij programi u pakësua me 82 milion lekë.

Projektet me Financim i Brendshëm.

Projektet me financim të brendshëm kryesisht janë projekte studimore në fushën minerare, të monitorimit të subjekteve minerare të licensuar në fushën e shfrytëzimit minerar, studimeve gjeologjike, gjeofizike, hidrologjike etj, kontrollit dhe verifikimit të mënyrës dhe formës së shfrytëzimit të rezervave minerare, verifikimit të zbatimit të projekteve të hapjes dhe shfrytëzimit për objektet minerare etj. Në përgjithësi këto projekte implementohet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Albaker, Albkrom dhe Albminierat.

Referuar të dhënave mbi shpenzimet faktike, rezulton se për periudhën Janar-Gusht 2018, shpenzimet në total janë realizuar në masën 35.4%. Në nivel programi realizimi i shpenzimeve korrente për katër/mujorin e dytë 2018 është 59.5 % dhe i shpenzimeve kapitale është 23%.

Plani Vjetor rishikuar 2018	Fakti 8/m 2018	% e realizimit
--------------------------------------	----------------------	-------------------

Shpenzime Korente	160.145	95.301	59.5%
Shpenzime kapitale	311.700	71.776	23%
<i>Financim i brendshëm</i>	311.700	71.776	23%
<i>Financim i huaj</i>	0	0	100%
TOTALI	471.845		35.4%
		167.077	

Shpenzimet kapitale zënë rreth 66% të shpenzimeve në nivel programi. Sipas qëllimeve të detajuara janë :

Qëllimi 1. Shfrytëzimi me eficence i burimeve natyrore nga shoqëritë e licensuara për këtë veprimtari nëpërmjet zbatimit të kushteve tekniko profesionale dhe mjedisore sipas standarteve europiane.

Objektivat e këtij qëllimi realizohen nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, nëpërmjet 6 projekte, për të cilët plani i buxhetit është 36 milion lekë dhe realizimi financiar 22.7 milion lekë si më poshtë:

Nr.	Emertimi i projektit	Buxheti për vitin 2018	Shpenzimet faktike 4 mujori i dytë i vitit 2018	Realizimi në % për 4 mujorin e dytë të vitit 2018
1	Dixhitalizimi i te dhenave te industrise minerare	2,000,000	-	-
2	Raport mbi monitorimin e objekteve minerare	19,000,000	12,810,000	67.4%
3	Planet minerare vjetore	3,000,000	1,740,000	58%
4	Raport vjetor mjedisor	4,000,000	2,760,000	69%
5	Objekte minerare te monitoruara	8,000,000	5,280,000	66%
6	Laborator i akredituar	2,000,000	180,000	9%
	Totali	36,000,000	22,770,000	63.32%

Qëllimi 2. Promovimi i burimeve hidrologjike, minerare të pashfrytëzuara për nxitjen e shfrytëzimit të burimeve minerare. Parandalimi i rreziqeve gjeologo - mjedisore, hidrologjike, nëpërmjet monitorimit, kryerjes së 25 studimeve dhe analizave paraprake në mbështetje të pushtetit qendror dhe lokal, me qëllim zgjidhjen e problemeve që janë evidentuar në infrastrukturë.

Objektivat e këtij qëllimi realizohen nga veprimtaria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Për këtë institucion në buxhetin e vitit 2018, janë planifikuar fonde për shpenzimet korrente (paga, sigurime shoqerore, shpenzime operative), ne shumen prej 160 milion leke dhe realizimi financiar eshte rreth 95 milion leke, ose 59% e planit e realizuar.

Projektet e investimeve me financim të brendshëm për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, janë 5 projekte.

- Ndërtim objekti të ri për Laboratorin e Gjeologjisë dhe ambienteve të tjera ndihmëse për SHGJSH Në proces të lidhjes së kontratës me shoqërinë fituese.
- Kolaudim i punimeve të laboratorit të ri të Gjeologjisë dhe ambienteve te tjera ndihmese, i cili është në fazën e përgatitjes së dokumentave të tenderit.

- Blerje automjeteve teknologjike për nevojat e SHGJSH. Ka përfunduar Loti i I-re për 4 automjete dhe është bërë furnizimi sipas kontratës. Loti i dytë 1 automjet është anuluar dhe do të rihapet procedura
- Blerje pajisje zyre. Në datë 14.05.2018 është hapur procedura nga Ministria e Brendshme dhe janë në fazën e vlerësimit dhe të shpalljes së fituesit.
- Blerje pajisje teknologjike. Është shpallur fituesi dhe është lidhur kontrata

Qëllimi 3. Mbyllja dhe monitorimi i fenomeneve të post shfrytëzimit minierar.

Për vitin 2018 janë parashikuar 93 milion lekë për mbylljen e 281 grykave të galerive të vjetra. Janë shpallur procedurat e tenderit për realizimin e këtij projekti dhe pritet të realizohet brenda vitit 2018.

Shoqëritë “Albbakër”sha, “Albkrom” sha dhe “Albminiera” sha, të cilat kanë në ruajtje ish minierat e vjetra dhe grykat e galerive kanë shumë detyrime të prapamendura që lidhen me pagat e punonjësve dhe sigurimet. Për këtë këto tri shoqëri kanë bërë disa kërkesa për fonde shtesë për pagesat e këtyre detyrimeve.

Qëllimi 4. Rritja e cilësisë në mirëqeverijen e industrisë nxjerrëse, nëpërmjet rritjes së transparencës në industri.

Ky qëllim realizohet nëpërmjet Sekretariatit për Nismë e Transparencës në Industrinë Nxjerrëse, me projektet e mëposhtme:

Emertimi i projektit	Buxheti për vitin 2018	Shpenzimet faktike 4 mujori i dytë i vitit 2018	Realizimi në % për 4 mujorin e dytë të vitit 2018
1. Transparenca në industrinë nxjerrëse (EITI)	12,500,000	6,348,000	51%
2. Hartimi i udhërefuesit EITI	26,000,000	-	-
3. Implementimi i të dhënave të integruara	15,000,000	-	-
4. Impelmentimi i hartës potenciale	11,000,000	-	-
Totali	64,500,000	6,348,000	10%

9. MBESHËTËTJE PËR INDUSTRIËN

Programi ka për qëllim zhvillimin e sektorit të industrisë joshqimore përmes rritjes së sigurisë të produkteve / pajisjeve / instalimeve dhe reduktimit të aksidenteve në punë dhe në miniera, rritjes së cilësisë së standardeve në treg të produkteve të naftës dhe gazit, minimizimin e rrezikut nga kimikatet e rrezikshme të papërdorshme gjendje në magazinat apo ambientet e ish ndërmarrjeve dhe subjekteve publike në varësi të MIE, administrimin e landfilleve me mbetje të rrezikshme të arsenikut dhe zhivës, likuidimin dhe mbylljen e ish ndërmarrjeve industriale, rehabilitimin e disa territoreve, si dhe objekteve ish industriale për tërheqjen e investitorëve vendas e të huaj, promovimin dhe nxitjen së interesit të biznesit për mundësi zhvillimi të veprimtarive industriale, si dhe rritjen e shkallës së përpunimit në vend të burimeve natyrore, me synim rritjen e kontributit në GDP, eksport dhe punësim,

Projektet me Financim i Brendshëm.

Projektet me financim të brendshëm, kryesisht, janë projekte investimi në fushën e industrisë joushqimore, për rritjen e kontrollit të standardeve në treg të naftës dhe gazit nëpërmjet monitorimit me aparatura laboratorike bashkëkohore, krijimin e kushteve të punës me pajisje profesionale për kryerjen e detyrave të inspektimit, shpëtimit dhe ndërhyrjeve emergjente në raste avarish dhe aksidentesh në punë dhe në miniera, administrimin e kimikateve të rrezikshme, gjendje në ish ndërmarrjet industriale dhe krijimin e kushteve sipas standardeve për grumbullimin dhe depozitimin e tyre ne QGTK, Elbasan, administrimin dhe ruajtjen e landfilleve të mbetjeve të rrezikshme, konservimin, ruajtjen e ish ndërmarrjeve industriale, deri në privatizimin e plotë të tyre, rehabilitimin e disa territoreve, si dhe objekteve ish industriale për tërheqjen e investitorëve vendas e të huaj për shfrytëzimin e tyre për parqe industriale dhe projekte studimore për zhvillimin dhe rritjen e shkallës së përpunimit në vend të burimeve natyrore vendase etj.

Buxheti i vitit 2018, për investimet me financim të brendshëm, është në shumën prej 153 milion lekë dhe realizimi financiar për periudhën 8 mujore, është në shumën prej 39,1 milion lekë, ose 25 % kundrejt planit e realizuar sipas objektivave të detajuara janë :

Objektivi 1. Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për monitorimin e sigurisë teknike të produkteve / pajisjeve / instalimeve, mbikëqyrjen e standardeve të tregut të produkteve të gazit dhe naftës, ndërhyrjet e shpëtimit në raste avarish në fushat e veprimtarisë së MIE-s.

Këto objektiva realizohen nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial. Për këtë institucion në buxhetin e vitit 2018, janë planifikuar fonde për shpenzimet korrekte (paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative), në shumën prej 163 milion lekë dhe realizimi financiar është rreth 86,4 milion lekë ose 52% e planit, e realizuar.

Projekt i investimeve me financim të brendshëm për Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial, është blerja e aparaturës laboratorike për treguesit cilësor të naftës dhe gazit, për të cilët plani i buxhetit është 18 milion lekë dhe është në fazën e kryerjes së procedurave të prokurimit dhe pritet të finalizohet lidhja e kontrates.

Objektivi 2. Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për sigurimin e kushteve të domosdoshme për inspektimin dhe mbikëqyrjen e shëndetit, sigurisë në punë, emergjencat dhe shpëtimit në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.

Ky objektivi realizohet nga veprimtaria e **Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera**. Për këtë institucion në buxhetin e vitit 2018, janë planifikuar fonde për shpenzimet korrente (paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative), në shumën prej 77,7 milion lekë dhe realizimi financiar është rreth 38,1 milion lekë, ose 49 % e planit e realizuar.

Projektet e investimeve me financim të brendshëm për **Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera**, janë 2 projekte të cilat janë në fazën e kryerjes së procedurave të prokurimit, do të lidhen kontratat përkatëse.

Objektivi 3. Rritja dhe përmirësimi i standardeve, kushteve të punës dhe të sigurisë së depozitimit dhe ruajtjes së kimikateve të rrezikshme në Qendrën e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme.

Ky objektivi realizohet nga veprimtaria e **Qendrës së Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan**. Për këtë institucion në buxhetin e vitit 2018, janë planifikuar fonde për shpenzimet korrente (paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative), në shumën prej 13 milion leke dhe realizimi financiar është rreth 5,4 milion lekë, ose 42 % e planit e realizuar.

Projektet e investimeve me financim të brendshëm për **Qendrën e Grumbullimit dhe Trajtimin të Kimikateve të Rrezikshme**, janë përgjithësisht në fazën e kryerjes së procedurave të prokurimit dhe lidhjes së kontratave përkatëse ndërsa projekti “Instalimi i sistemit të vëzhgimit me kamera” është realizuar 100%.

Objektivi 4. Përfundimi i procesit të likuidimit dhe mbylljes së ish ndërmarrjeve industriale në varësi të MIE-s. Rehabilitimi i territoreve të ish ndërmarrjeve për nxitjen e investitorëve dhe promovimin e tyre për përdorim, si parqe industriale.

Ky objektivi realizohet nga aparati i MIE-s për financimin e Ndërmarrjes Përpunimit të Çeliqueve Elbasan, Kombinati Energjetik Elbasan, Uzina e Plehrave Azotike Fier dhe Prodhim Mobilje Sha Tirane

Rehabilitimi i territoreve të ish ndërmarrjeve për nxitjen e investitorëve dhe promovimin e tyre për përdorim, si parqe industriale, realizohet nga aparati i MIE-s nëpërmjet projekteve të investimeve, si më poshtë:

Emërtimi i projektit	Buxheti për vitin 2018	Shpenzimet faktike 4 mujori i dytë për vitin 2018	Realizimi në % për 4 mujorin e dytë të vitit 2018
- Azotiku - Kolaudim për rehabilitimin e uzinës	200	165	83%
Hartimi I projektit për rehabilitimin e Uzinës bakrit	960	-	-
Rehabilitimi I Uzinës së Rafinimit të Bakrit	57,340	-	-
Supervizim për Rehabilitimin e Uzinës së Rafinimit të Bakrit	1,600	-	-
Kolaudim I punimeve për rehabilitimin e Uzinës së Bakrit Rubik	100	-	-

Objektivi 5. Promovimi tek biznesi i studimeve tekniko-ekonomike për industrinë e lëkurë- këpucës, industrisë së bakrit, nikel silikateve dhe kuarciteve, zhvillimit të QGTK dhe hartimi i raporteve mjedisore, si dhe zhvillimi i disa ish territoreve industriale për ushtrimin e veprimtarive ekonomike.

10. PLANIFIKIMI URBAN

Shpenzimet në këtë program përfshijnë Aparatin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për shpenzimet kapitale, dhe AQTN dhe AKPT për shpenzimet korrente.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi i shpenzimeve të këtij programi, paraqitet si më poshtë (në mijë lekë) pas Aktit Normativ nr. 1 datë 26.07.2018:

	Viti 2018		
	Plani	Fakti	% e realizimit
• Shpenzime korrente	97 700	51 552	53
• Shpenzime kapitale	165 500	34 482	21

INVESTIMET PUBLIKE ME FINANCIM TË BRENDSHËM:

Për programin “Planifikim Urban” janë parashikuar, në total, rreth 263.2 milionë lekë, nga të cilat rreth 112.624 milionë lekë për Agjencinë Kombëtare të Planifikim Territorit (AKPT), rreth 40.576 milionë për Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit (AQTN), dhe rreth 110 milionë për Aparatin e MIE.

INVESTIMET ME FINANCIM TË HUAJ

Investimet publike me financim të huaj, për vitin 2018, janë planifikuar në rreth 410 milionë lekë dhe deri në fund të vitit, janë realizuar në rreth 281.725 milionë lekë ose rreth 68.7%.

Për projektin “Zhvillimi i integruar dhe i qëndrueshëm i zonës bregdetare, GIZ” janë parashikuar 82.440 milionë lekë dhe deri në fund janë realizuar rreth 46.877 milionë lekë. Qeveria Gjermane nuk lëvront fonde direkt për sistemin buxhetor shqiptar, por shërbime në natyrë, për të cilat pagesat bëhen direkt nga llogaritë e donatorit.

Për projektin “Hartimi i master planit në fushën e mbetjeve, KfW” janë parashikuar 15.340 milionë lekë dhe deri në fund të vitit, janë realizuar në rreth 23.649 milionë lekë. Është nënshkruar marrëveshja nga KfW dhe Ministria e Financave, duke vijuar me hartimin e dokumentave sipas fazave të përcaktuara në marrëveshje, si dhe është bërë shtyrja e kontratës edhe për vitin 2019.

Për projektin “Programi i Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë”, për vitin 2018, janë planifikuar në rreth 302.220 milionë lekë dhe deri në fund të vitit, janë realizuar 205.731 milionë lekë, nga shpenzimet me financim të huaj. *Ky projekt ka përfunduar, sipas Marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 66/2017, datë 20.04.2017, më 30 Shtator 2018, ku MIE, në zbatim të VKM nr. 509, datë 12.08.1996 “Për mënyrën e përballimit të TVSH-së që lidhet me zbatimin e projekteve të financuara nga donatorë e organizma të ndryshëm ndërkombëtarë”, duhet t’i likuidonte donatorit vlerën e TVSH-së prej 1,580,203.99 lekë (një milion e pesëqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e tre pikë nëntëdhjetë e nëntë), sipas faturave për periudhën dhjetor 2017 – shtator 2018, ku sipas buxhetit të miratuar të PBA 2018-2020, për vitin 2018 ka vlerën 35,200,000 lekë, e sipas AN nr, 1, datë 26.07.2018, rezulton me vlerë 0 lekë.*

Referuar Aktit Normativ nr.1, datë 26.07.2018, buxheti për këtë Program “Planifikimi Urban” është pakësuar në vlerën 75,200 mijë lekë në Aparatin e MIE, me ndikim në dy projekte, duke hequr 40 milion lekë për “Hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore për 16 bashki”, si dhe 35.2 milion lekë për “TVSH-në e Programit të Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë”, me status aktiv të këtij programi, si dhe shtesë në buxhetin e AKPT-së me 7 milion lekë për Projektin “Projekt studimi për ndërtimin e Shkollës së Magjistraturës”.

Për projektin “BRIGAD”, për vitin 2018, janë planifikuar në rreth 10 milionë lekë dhe deri në fund të vitit, janë realizuar 5.467 milionë lekë, nga shpenzimet me financim të huaj.

